



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEQA"

Syllabusi i lëndës: Kontabiliteti Financiar i Avancuar

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Biznesit
Titulli i lëndës:	Kontabiliteti Financiar i Avancuar
Niveli:	Master
Status i lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	I
Numri i orëve në javë:	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësit e lëndës:	
Detajet kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës	Kontabiliteti shtjellon si në aspektin teorik ashtu edhe në atë praktik: financimin e korporatave përmes borxhit (obligacionet e pagueshme), financimin e korporatave përmes ekuitetit (aksionet), ekuitetin e ortakërive, investimet financiare dhe metodat e aplikuara për regjistrimin kontabël të investimeve financiare, konsolidimet, bashkimet, pasyrën e cash flow-it dhe metodat e përpilimit, analizën e pasqyrave financiare përmes treguesve financiarë.
Qëllimet e lëndës:	- o Fitimi i njohurive të reja të natyrës teorike dhe praktike, nga fusha e kontabilitetit financiar, - o Ofrimi i mundësive reale për krijimin e kuadrit profesional për zbatimin e njohurive të fituara kontabile, për njohjen, përpunimin, regjistrimin e transaksioneve financiare te subjektet afariste në veprimtaritë prodhuese dhe shërbyese, - o Krijimi i pasqyrave financiare dhe dokumenteve përcjellëse, - o Fitimi i njohurive për analizën fillestare të pasqyrave financiare dhe komentimi i treguesve financiarë.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Njohuri (NJ): *NJ1. Zotërojnë njohuri të avancuara teorike dhe praktike mbi kontabilitetin financiar, duke përfshirë krijimin e informacionit kontabël për mbështetjen e vendimeve afariste. *NJ2. Njohin dhe klasifikojnë transaksionet financiare që lidhen me detyrimet afatshkurtra, përfshirë borxhet e tregut, obligacionet dhe detyrimet e tjera financiare.

	*NJ3. Përvetësojnë metodat e kalkulimit dhe kontabilizimit për dëftesat e pagueshme, kontratat e leasing-ut dhe hipotekat e pagueshme, si dhe kuptojnë implikimet financiare për subjektin afarist. *NJ4. Ndërtojnë njohuri të thelluara mbi format e financimit të korporatave dhe strategjitë për optimizimin e strukturës financiare të ndërmarrjes. *NJ5. Kuptojnë dhe zbatojnë metodat për kalkulimin dhe kontabilizimin e investimeve financiare, duke përfshirë investimet në tituj të tregut dhe instrumente financiare të tjera. *NJ6. Thellojnë njohuritë mbi financimin e subjektit afarist, ruajtjen e substancës së kapitalit dhe raportimin e ndryshimeve në ekuitet, duke reflektuar në qëndrueshmërinë financiare dhe performancën afatgjatë të ndërmarrjes. Aplikim – Kompetenca (A-K): **A-K1. Përdorin njohuritë e fituara për të përgatitur pasqyra financiare dhe dokumente të tjera mbështetëse në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe raportimit financiar. **A-K2. Zbatojnë teknika të avancuara të analizës financiare për të interpretuar pasqyrat financiare dhe për të komentuar mbi treguesit kyç të performancës financiare të subjektit afarist. **A-K3. Zhvillojnë aftësi në hartimin e projekteve financiare dhe planifikimin strategjik financiar të korporatave, duke përdorur analiza kosto-përfitim dhe metoda të tjera për vlerësimin e investimeve. **A-K4. Përdorin njohuritë kontabël për të identifikuar dhe përpunuar informacionin financiar që ndihmon në menaxhimin e rrezikut dhe në përmirësimin e kontrollit të brendshëm të organizatës. **A-K5. Zbatojnë praktika të menaxhimit financiar dhe kontabël për të vlerësuar efikasitetin operacional dhe për të dhënë rekomandime për përmirësimin e performancës financiare. Aftësi (A): ***A1. Prezantojnë në mënyrë të qartë dhe bindëse informacionin kontabël dhe rezultatet e analizave financiare, duke përdorur teknika profesionale të komunikimit dhe prezantimit. ***A2. Bashkëpunojnë në mënyrë efektive në punë ekipore, duke udhëhequr dhe kontribuar në projekte të përbashkëta për përmirësimin e sistemeve kontabël dhe financiare të subjektit afarist.
--	--

	***A3. Demonstronjë aftësi analitike dhe kritike për të adresuar dilema komplekse kontabël dhe për të dhënë rekomandime të argumentuara për vendimarrjen strategjike. <i>Sqarim:</i> Rezultatet e pritura të syllabusit janë të përpiluara konform rezultateve të pritura të programit, në përputhje me standardet e AKA-së. *Njohuri (Nj) **Aplikim-Kompetenca (A-K) ***Aftësi (A)
--	---

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjerata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	10	10
Ushtrime në teren	2	5	10
Seminare, projekte, prezentimet,etj.	10	1	10
Koha e studimit vetanë të studentit	2	15	30
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	10	1	10
Përgaditja përfundimtare për provim	5	1	5
Totali			150

Sqarim: 1 orë = 25 ECTS kredi.

Përshtatja e ECTS me orët totale: 150 orë ÷ 25 = 6 ECTS kredi.

Metodologjia e mësimdhënies:	○ Mësimdhënia do të zhvillohet përmes ligjëratisë, detyrave praktike, interpretimeve individuale e grupore, vetëvlerësimeve periodike, etj. ○ Të gjitha këto do të realizohen në aspektin teorik dhe praktik duke i prezantuar materialet në formën audio-vizuele përmes teknologjisë elektronike me programeve të Windows Office. ○ Në aspektin teorik do të ofrohen njohuri të përgjithshme shkencore, bazuar në literaturën bashkëkohore. ○ Pjesa praktike kryesisht do të realizohet përmes shembujve konkret nga literatura dhe nga njohuritë
-------------------------------------	---

	praktike. Në këtë mënyrë do të synohet krijimi i raporteve ndërvepruese profesor-student si dhe ai student-student.
Metodat e vlerësimit:	• Testi i parë vlerësues: 0 – 40% • Testi i dytë vlerësues: 0 – 40% • Punimi shkencor (meta – analizë): 0 -20% • Provimi përfundimtar 0 - 80%
Literatura	
Literatura bazë:	▪ <i>Kontabiliteti Financiar, Prof.Dr. Etem Iseni, Mr. Fekri Iseni, 2015</i> ▪ <i>Ligjerata të përgatitura nga profesori i lëndës në fushën e kontabilitetit financiar të avancuar</i> ▪ <i>Rrustem Asllanaj (2013)- "Kontabiliteti financiar"(Pjesa II), Universiteti i Prishtinës.</i>
Literatura shtesë:	▪ <i>Richard Lewis, David Pendrill (2003) – Advanced Financial Accounting, Pearson Education Canada; 7th edition.</i> ▪ <i>Theodore Christensen, David Cottrell, Richard Baker (2013) - Advanced Financial Accounting, McGraw-Hill Education; 10th edition.</i>
Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Hyrje (Prezantimi i lëndës, metodat e punës dhe vlerësimit)
Java e dytë:	Natyra e korporatave, llojet e aksioneve, kapitali i korporatës dhe kontabiliteti për aksionet e shitura
Java e tretë:	Kontabiliteti i dividendit
Java e katërt:	Kontabiliteti i aksioneve të thesarit dhe ndarja e dividendit në kesh ndërmjet aksioneve preferenciale dhe aksioneve të rregullta (zakonshme)
Java e pestë:	Kontabiliteti i obligacioneve – emetimi i obligacioneve me diskont, amortizimi i diskontit, emetimi i obligacioneve me premi, amortizimi i premisë
Java e gjashtë:	Shitja e obligacioneve ndërmjet datave të ndryshme të periudhës së kamatës dhe shitja e obligacioneve baraz me vlerën nominale
Java e shtatë:	Tërheqja e obligacioneve para maturimit

Java e tetë:	Testi i parë vlerësues
Java e nëntë:	Kontabiliteti i qirasë kapitale (lizingu)
Java e dhjetë	Tatimi i shtyrë
Java e njëmbëdhjetë:	Investimet në letra me vlerë – blerja e obligacioneve me premi dhe me diskont
Java e dymbëdhjetë :	Investimet në letra me vlerë të tregtueshme dhe investimet në letrat me vlerë në gjendje për tu shitur
Java e trembëdhjetë:	Investimet në aksione me metoden e ekuitetit
Java e katërbëdhjetë:	Kombinimet e bizneseve dhe pasqyrat e konsoliduara financiare
Java e pesëmbëdhjetë:	Testi i dytë vlerësues Prezentimi i punimeve shkencore (meta – analizës)

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Politikat e mirësjelljes konform statusit të UHZ-së.

- Para së gjithash, studenti duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të respektojë institucionin dhe rregullat shkollore;
- Duhet të respektojë orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe të jetë i vëmendshëm në orën mësimore;
- Është i obliguar posedimi dhe paraqitja e indeksit dhe mjetit të identifikimit në teste dhe provim;
- Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studenti duhet të përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësuesi për realizimin hulumtues dhe teknik të punimit;
- Testet dhe provimet vlerësohen individualisht për secilin student. Prandaj, studentet duhet të përqëndrohen vetëm në njohuritë personale.
- Shkelja eventuale e këtyre parimeve etike (rregullave) ndëshkohet konform normave të parapara me ligj.